



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”

Konsultim publik : *Banoret e Nj. Administrative Dajç*

Data : 15.10.2021

Ora : 15.00

Vendi: Salla e mbledhjeve Njësia Adminsitrative Dajç

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesmarrësve 33, nga të cilat 7 gra dhe vajza*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Draft projekt plani buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Kryetare e bashkisë znj. Voltana Ademi, Administrator i Nj.Administrative z. Arben Ceni, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadija, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise se Bujqesise z. Alban Sekja, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj.Aulida Anamali, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë Znj. Voltana Ademi dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtruan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me fushat e konsultuara si më poshtë vijon:

I. ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. Z.Larushku, drejtoreshë e shkollës

- a. Shprehet se është e kënaqur me mbështetjen që ka dhënë bashkia në lidhje me shkollën që ajo drejton. Së fundmi ajo ka bërë kërkesë pranë drejtorisë ekonomike të arsimit:

- b. Për ndërtimin e një këndi sportiv sepse moti i keq behet pengesë për zhvillimin e orës së edukimit fizik.
- c. Po ashtu edhe rrethimi i shkollës ka nevojë për meremetim sepse shpesh herë krijohen situata të pakëndshme me persona jashtë shkolle.
- d. Gjithashtu shkolla që ajo drejton ka nevojë për mirëmbajtje, në kopsht, tek hyrja e shkollës dhe lysterje të pjesshme.

2. Z.Florian Shabani

- a. që duhet ndërhyrë menjëherë në shkollën “Pjetër Gaci” në Shirq. Tualetet janë jashtë funksioni.
- b. Shkolla ka nevojë edhe për një edukatore ,sepse ka 30 fëmijë.

3. Drejtoresha e shkollës së bashkuar.

- a. Shkolla që ajo drejton ka nevojë për rikonstrukcion të katit të parë. Lysterje të ambjenteve mësimore.
- b. Shqetësim tjetër është edhe mungesa e ambjenteve sportive. Ajo mendon që pajisja me pajisje sportive do të ishte edhe në të mirë të komunitetit.
- c. Transporti i nxënësve është problematik, sepse shumë nxënës ndjekin shkolla profesionale ne Shkodër dhe nuk i janë përcaktuar konkretisht linjat. Për më tepër që kjo ndikon edhe financat familjare te këtyre nxënësve.

4. Edhe Z.Valbona Gjushi ngre të njëjtin shqetësim, në lidhje me transportin e fëmijëve. Ato banojnë larg dhe transporti nuk financohet.

5. Z.Kanto

- a. po ashtu e sheh shumë problematik transportin e fëmijëve për në shkollë.

6. Z.Hamdi Milloja,

- a. kërkon të dijë mbi çfarë kriteresh bëhet akt-miratimi higjieno-sanitar në shkolla. Sepse ka një sërë problemesh me to. Zgjidhja nuk varet nga drejtorja e shkollës.

7. Drejtoresha e kopshtit

- a. shpreh shqetësimin e saj në lidhje me mungesën e stafit sepse ka fluks fëmijësh që frekuentojnë kopshtin dhe janë të grupmoshave të ndryshme.
- b. Ajo gjithashtu kërkon që godina ka nevojë për disa rregullime në tualete etj.
- c. Edhe ne kopshtin e fshatit Pentar nuk ka tualete dhe transporti vazhdon të mbetet problem.

8. Z.Lindita Shkurtaaj, mësuese kërkon;

- a. Shtesë të një edukatoreje.
- b. Lejimin e bërjes së stazhit në njësinë më të afërt në bazë te nevojës, nëse e lejon ligji.

II. MENAXHIMI I MBETJEVE

- 1. **Z.Kanto** merr fjalën dhe tregon se kontinjerët e mbeturinave janë të dëmtuar dhe mbeturinat depozitohen në tokë për një kohë të gjatë. Ai kërkon;
 - a. Të shtohet frekuenca e pastrimit dhe të zëvendësohen kontinjerët.

2. Edhe **Z.Tome Pjetrani** ndan të njëjtin shqetësim për mbeturinat dhe shprehet se fshatarët duhet të ndërjegjësohen dhe të mos i hedhin pemët dhe krasitjet në kontinjerë, por të gjindet një zgjidhje tjetër.

III: SHERBIMET PËR KOMUNITETIN

Shqetësim tjetër i banorëve është edhe Pastrimi tek varrezat e fshatit.

1. **Z.Lindita Shkurtaj** merr fjalën dhe kërkon;
 - a. Ndërhyrje në këtë zonë.Ajo propozon edhe që të bëhen varreza familjare,me kate.Pagesa mund të kryhet edhe nga vetë familjarët aty.
2. **Z.Ylli Kola**,sqaron se varrezat kanë nevojë edhe për mirëmbajtje dhe pastrim, sidomos para festave.
 - a. Ai kërkon që pastrimi, të kryhet një herë në muaj.

IV: NDRICIMI RRUGOR

Ne lidhje me ndricimin rrugor,

1. **Z.Kole Mazija** shprehet se
 - a. në fshatin e tij nuk ka fare ndricim edhe pse ato janë taksapagues të rregullt.
 - b. Po ashtu edhe gjimnazi nuk ka ndricim.
 - c. Edhe në hyrje të fshatit Dajc, Darragjat mungon ndricimi dhe kjo mund të bëhet edhe shkak aksidentesh.
 - d. Ai kërkon: Marrje masash në lidhje me ndricimin e zonave të lartpërmendura.
2. **Z.Altin Salih** merr fjalën dhe sqaron se pagesa e tarifave bëhet sipas kriterëve përkatëse dhe në disa fshatra ndricimi kryhet me bashkëfinancim. Sic është rasti i fshatit Shirq.

V. SHERBIMI I KULLIMIT

1. Fjalën e merr përsëri **Z.Kole Mazija** ,i cili shpreh shqetësimin më të madh për banorët,problemin e kullimit.Ai kërkon;
 - a. Pastrimi kanaleve nuk bëhet si duhet dhe ka shumë pakënaqesi.Edhe niveli i tokës është i ulët, prandaj edhe përmytjet janë shumë të mëdha në këtë zonë dhe bëjnë shumë dëme.
2. Edhe **Z.Osman** propozon;
 - a. Një grafik të saktë për pastrimin e kanaleve.
 - b. Edhe për mbetjet organike duhet gjetur zgjidhje.Duhen kryer më shumë kontrolle.
3. **Z.Hamdi**, kryetar fshati thotë që duhet bashkëpunim edhe ne si fshatar duhet të ndihmojmë e të jemi mirëkuptues. Punë është bërë dhe vazhdon. Ne KK6 ka fillu pastrimi edhe vetë fshatarët duhet me pastru kanalët e kullimit nga degët që kanë hedhur vetë. Por ai mendon dhe kërkon;
 - a. Që kontrolli i territorit të bëhet i saktë, dhe kjo ndoshta është një nga arsyet e bllokimit të kanaleve.

4. Po ashtu të njëjtin shqetësim ndan edhe **z.Vitor Lakaj** që kërkoj;
 - a. Rishikimin e cilësisë së kanaleve.Konkretisht kanali i tretë në Samrisht duhet të shkojë në kuotë.Probleme ka edhe në Suka Dajc, Rrushkull, Belaj, Shirq e Mushan.
5. **Z.Ernest Lukaj** merr fjalën dhe shprehet se ceshtja e kullimit është kryesore.Sistemi i kanaleve kullues ndahet në tre kategori. Dy janë kolektorët ujëmbledhës,të bordit që i trajton ministria e bujqësisë.Ai kërkon;
 - a. Ndërhyrje tek dytët dhe të tretët.Eshtë punuar shumë tek të tretat në zonën e Shirqit,Mushanit e shumë fshatra të tjerë. Janë 16 km konektorë të dytë.
 - b. Ndërhyrje tek bordi kk5 dhe kk6.
 - c. Pastrimi të kryhet sipas një frekuence të caktuar.
 - d. Shqetësim tjetër për banorët e zonës është shërbimi i ujitjes dhe admnistrimi i pyjeve.

VI. RRJETI RRUGOR RURAL

1. **Banorët e fshatit Samrish** i ri shprehen se shqetësimi i tyre vazhdon të jetë mospasja e një rruge dhe mungesa e ndricimit. Ato kërkojnë;
 - a. Që të ndërhyhet menjëherë në shtrimin e rrugës lidhëse.
 - b. Po ashtu tjetër segment problematik është edhe rruga për tek varrezat te Sukaj Dajc.Ajo rrugë bëhet shumë e rrezikshme në dimër.
 - c. Tjetër rrugë, që ka nevojë për ndërhyrje është rruga në fshatin Rrushkull.Edhe rruga tek varrezat katolike të Dajcit ka nevojë të shtrohet.
 - d. Edhe rruga për tek xhamia duhet të shtrohet.Janë vetëm 330 metra rrugë dhe është i vetmi objekt kulti për tre fshatra.
 - e. Rruga për tek shkolla ‘Pjeter Gaci’është e dëmtuar dhe është e vetmja rrugë që të çon aty.
2. Z.Ademi kërkon të dijë se sipas banorëve cilat janë rrugët më me prioritet, të cilat mund t’i përfshijnë në buxhetin e këtij viti.

Për të gjithë pjesemarresit u shpërndanë flete vlerësimi për të përcaktuar prioritetin për investime në rrugë rurale. Propozimet janë listuar mëposhtë:

- a. Rr.Samrish I Ri
- b. Rr.Gjyshajve
- c. Rr. Mandajve
- d. Rr.Mushanit
- e. Rr.Dakajve
- f. Rr.Shirq
- g. Rr.Darragjatit
- h. Rr.Dajç
- i. Rr.Mali I Gjymtit
- j. Rr.Belaj
- k. Rr.Rrushkull
- l. Rr.Sukave
- m. Rr.Pentarit


Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit
Fisnik Lutfija.









BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
Njesia Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
1.	HAMDI	MALDOJA	M	63	MUSHATI	INSPEKTOR VETERINER	AKU SHKODËR
2.	VITOR	LAKAJ	M	74	SAM. RI	FERMER	PENSIONIST
3.	DIETER	KOLA	M	65	DFJÇ	ARSIMTAR	ARSIMTAR
4.	ALBINA	KULLA	F	47	SHKODËR	ARSIMTARE	DREJTORESH SHKOLLA DAJÇ
5.	EMIRA	LUKAJ	F	34	DJAJÇ	INFERMIERE	INFERMIERE
6.	BRYHILLA	GJONI	F	26	SAMRISH VET	ARSIMTARE	PA PUNE
7.	OSMAN	OSMANI	M	73	SHIRQ	AGROLOGU	PENSIONIST
8.	TOM	PJETRANI	M	61	SAMRISH VJ	FERMER	VETERINERORAC
9.	LINDITA	SHUKETAJ	F	45	BEUJAJ	ARSIMTARE	PA PUNE
10.	GERIJA	METALAJ	M	54	MUSHAN	FERMER	K. FUSHI MUSHAN
11.	KOL	MARAJA	M	65	SUKH DAJÇ	FERMER	K. FUSHI SUKHA DAJÇ
12.	ARDITA	CARUSHAKU	F	-	SHKODËR	DREJTORE	SHKOLLA 9-DËSH PJETËR GJAJÇ
13.	ANILA	BARBUKULLASHI	F	43	SHKODËR	Dr. Lore Kapahi	Drejtoria nr.10

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
Njësia Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
14.	Andrita	Liti	Femër	52	SHKODER	EDUKATORE	SHKOLLA "SHIRQI"
15.	GJERGJ	DAKA	M	60	DAJÇ	FERMER	VETERPUNESUAR
16.	GJON	FRASHI	M	59	BEJAZ	FERMER	K. FSHATI BEJAZ
17.	EURIKO	DAKA	M	24	DAJÇ	INFERMIER	INFERMIER
18.	GTON	KALAVACI	M	55	PENTAR	FERMER	K. FSHATI PENTAR
19.	BAHRI	TULLEFI	M	73	RRUSKULL	FERMER	K. FSHATI RRUSKULL
20.	KANTO	NUÇAJ	M	60	NAJLI GJYNTA	FERMER	K. FSHATI NAJLI GJYNTA
21.	MIRJAN	KORSHI	M	38	DAJÇ	FERMER	VETERPUNESUAR
22.	ADRIANO	GJUSHI	M	28	DAJÇ	BIZNESMAN	BIZNES
23.	MARK	KOLAJNI	M	66	SHIRQ	FERMER	K. FSHATI SHIRQ
24.	ERNEST	LUKAJ	M	39	DAJÇ	EKONOMIST	NJA DAJÇ
25.	EMILJAN	LIXANDHI	M	38	SUKU DAJÇ	FERMER	NJA DAJÇ
26.	ERNEST	LUKA	M	64	DAJÇ	AGRONOM	NJA DAJÇ

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
Njesia Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
27.	FLOKIAN	SHABANI	M	38	SHIRO	BIZNES	BIZNESMAN
28.	EMILJAN	BUJSHI	M	38	DAJÇ	FERMIER	PA PUNE
29.	ALBANA	BUJSHI	F	39	DAJÇ	ARSIMTARE	PA PUNE
30.	FIJUP	KERCUNGA	M	62	VEUPOJE	FINANCIER	NJA DËS / VEUPOJE
31.	MARILIND	MANDI	F	35	DAJÇ	EKONOMISTE	NJA DËS NE
32.	FLAVORA	LUKAJ	F	30	DAJÇ	PSIKOLOGE	NJA DËS / BERNJE / VETËPUNUAR
33.	SHABAN	SHABANI	M	59	SHIRO	BIZNESMAN	VETËPUNUAR
34.	PAJUN	MASAJ	M	54	SHIRO	BIZNESMAN	VETËPUNUAR
35.	HYLLI	KOLAJ	M	37	SANRSHI VJET	FERMIER	NJA DËS

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____